

VENDIM
Nr.471, datë 15.7.1996

**PËR KOMPENSIMIN NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË BUKËS, VAJGURIT DHE GAZIT
TË LËNGSHËM**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Për efekt të ndryshimit të çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm, t'u jepet kompensim:
 1. Në masën 250 lekë në muaj:
 - a) Të punësuarve në sektorin shtetëror e privat, në shoqëritë tregtare, bankat, INSIG, ISSH, ISKSH, organizatat politike e shoqërore dhe në shoqatat.
 - b) Personave që trajtohen me pagesë nga ARN-ja.
 - c) Ushtarakëve që kanë dalë në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura.
 2. Në masën 150 lekë në muaj:
 - a) Personave që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 "Për sigurimet shoqërore", ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur janë me banim të përhershëm në qytet, si edhe personave që marrin pension nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të atyre që sipas nenit 96 të këtij ligji nuk plotësojnë kushtet për të përfituar masë pensioni shtetëror.
 - b) Personave që përfitojnë pagesë paaftësie.
 3. Niveli bazë i pagesës së papunësisë dhe niveli maksimal i ndihmës ekonomike të plotë që përfiton familja rritet 12%.
- II. Nuk përfitojnë kompensim mujor:
 1. Punonjësit e administratës së lartë shtetërore, shpërblimi i të cilëve bëhet me pagë mujore të fiksuar.
 2. Pensionistët, që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" dhe ata që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas nenit 96 të këtij ligji, marrin masë pensioni fshati, kur banojnë në fshat dhe në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore.
 3. Të vetëpunësuarit në sektorin privat, nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.
 4. Punonjësit që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime pasuniversitare ose për të ndjekur kurse mbi tre muaj.
- III. Mënyra e llogaritjes dhe e pagesës së kompensimeve:
 1. Familjet bujqësore me të ardhura të pamjaftueshme, kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm do ta përfitojnë pranë zyrave të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në komuna, nëse niveli i të ardhurave të tyre përfshihet në kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike.
 2. Kompensimet paguhen një herë në muaj në fillim të muajit për muajin korrent dhe regjistrohen në një kolonë të veçantë të listëpagesës.
 3. Të ardhurat personale nga kompensimet nuk tatohen.
 4. Në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore, ky kompensim nuk përfshihet në pagën mesatare për efekte të kontrollit.
- IV. Fondet për kompensimin në zbatim të këtij vendimi përballohen:
 - a) Nga Buxheti i Shtetit për punonjësit e institucioneve buxhetore, për personat që marrin pension, personat që përfitojnë pension, pagesë papunësie, pagesë paaftësie, ushtarakët e dalë në lirim nga reforma, personat që trajtohen me pagë nga ARN-ja, si dhe për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.
 - b) Nga vetë subjektet për të punësuarit në shoqëritë tregtare, bankat, INSIG, ISKSH, ISSH, organizatat shoqërore dhe shoqatat.
- V. Organizatat politike sipas ligjit të partive u jepet financim shtesë.

VI. Efekti financiar në Buxhetin e Shtetit do të përballohet nga fondi i parashikuar në buxhet për vitin 1996 në zërin “Kontingjencë” prej 400 milionë lekësh, si dhe nga pjesa e subvencionit të diferencës së çmimit të grurit të papërdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, sipas urdhrit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Ngarkohet Ministria e Financave për të bërë detajimin dhe shpërndarjen e këtij fondi sipas drejtimeve të përdorimit në zbatim të këtij vendimi.

VII. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore hartojnë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 korrik 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi